



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Departmanti i Inspeksionit të Arsimit - Sektori i Inspeksionit të Arsimit - Gjakovë

Datë: 5 qershor 2015
Ref. 237/10/1-6

PROCESVERBAL

**i mbajtur me rastin e inspeksionit special në Fakultetin e Edukimit - Qendra në
Gjakovë (ish Shkolla e Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" në Gjakovë)**

I. HYRJE

Duke u bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4.3 të Ligjit për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Urdhëresës Nr. 180/01B datë 27.04.2015 të Kabinetit të Ministrit, Sektori i Inspeksionit të Arsimit në Gjakovë, me datë 04.05.2015, ka bërë inspeksion special në Fakultetin e Edukimit-Qendra në Gjakovë (ish Shkolla e Lartë Pedagogjike në Gjakovë). Qëllimi i këtij inspeksioni ishte verifikimi i diplomave të lëshuara nga ana e këtij fakulteti për mësuesit të cilët janë të dyshuar për falsifikimin, dyshim i ngritur edhe në formë aktakuze nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjakovë në bazë të dokumentit PP. nr. 155/2009 dhe 505/2009 të dt. 24.03.2015. Një aktakuzë e tillë është ngritur kundër 84 mësuesve, të cilët punojnë apo kanë punuar në shkollat e komunës së Malishevës dhe të Rahovecit. Këta mësues akuzohen për vepër penale, *falsifikim të dokumenteve zyrtare, përkatësisht të diplomave të marra në ish SHLP "Bajram Curri" në Gjakovë.*

Në inspeksion kanë marrë pjesë inspektorët: Zef Osmani, Hasan Sadriu, Qerim Kastrati dhe Gjergj Gojani si dhe drejtori i Departamentit, z. Dëfrim Gashi, në aspektin menaxherial.

Inspeksioni është bërë në pajtim me Ligjin Nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë (neni 4, paragrafi (h) dhe (p)) dhe UA për procedurën administrative të inspeksionit në institucionet edukativo- arsimor dhe shkencore (nr. 11/2005, 4 prill 2005).

Paraprakisht (më 29.04.2015) është njoftuar institucioni dhe më datë 04.05. 2015 ka filluar inspeksioni. Inspeksioni ka filluar në ora 9.00 të kësaj date (pra 04.05. 2015). Në ditën e

inspektimit kemi takuar Prof. Asoc. Dr. Ilir Kelmendin, aktualisht U. D prorektor për çështje mësimor në UGJFA dhe njëkohësisht dhe përgjegjës (koordinator) i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës- Qendra në Gjakovë.

Në kohën e inspektimit prezent ishte z. Albert Vula, referent për çështje të studentëve pranë këtij fakulteti (Fakulteti i Edukimit i UP “H. Prishtina”- Qendra në Gjakovë, i cili ka ofruar tërë dokumentacion që kishte në dispozicion. Dokumentacioni i ofruar nga z. Vula ka qenë:

1. Amza e të diplomuarve me plan-program dyvjeçar me korrespondencë
2. Amza e të diplomuarve me plan-program dyvjeçar të rregullt
1. Amza e të diplomuarve me plan-program dyvjeçar në Degën Mësim Klasor (me korrespondencë)
2. Amza e të diplomuarve me plan-program dyvjeçar në Degën Mësim Klasor (të rregullt)

Po ashtu nga zyrtari në fjalë, z. Albert Vula inspektorët janë njoftuar se dosjet e mësimdhënësve në fjalë, janë në procedim në Gjykatën Themelore të Gjakovës në Gjakovë. Më qellim të informimit zyrtar, inspektorët arsimorë njoftimin e kanë marrë edhe me shkrim (Shkresa Nr. 02-13, datë 04.05.2015).

Me shkresën Ref. Nr. 203/10/1-6, datë 04.05.2015, inspektorët kanë kërkuar nga Drejtori i Inspeksionit të Arsimit, z. Dëfrim Gashi sugjerim për veprimet e mëtejshme në lidhje me realizimin e inspektimit, të kërkuar sipas urdhëresës së MASHT-it. Nga drejtori i inspeksionit ka ardhur sugjerimi për kontaktim të Gjykatës Themelore të Gjakovës, me qellim të tërheqjes së dosjeve të mësimdhënësve, apo të gjetjes së ndonjë mundësie tjetër për inspektim të këtij dokumentacioni.

Më datën 06.05.2015, nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë është kërkuar kthimi i dosjeve të marra sipas Memorandumit Zyrtar me nr. Reference DHKEK/NJHKEK-RPE 238/2010, datë; 16.12.2010, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe të deponuara në Gjykatën Themelore në Gjakovë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr. 155/2009 dhe 505/2009 të dt. 24.03.2010.

Bazuar në kërkesën (Ref. Nr.205) tonë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë kemi marrë përgjigjen me datën 12.05.2015, në të cilën thuhet se: “ Në bazë të kërkesës dhe bisedës që e patëm sot, konsiderojmë se më e përshtatshme do të ishte që Ju të vini në objektin e Gjykatës për të kryer punën tuaj të inspektimit të dokumentacionit përkatës, ku personeli ynë do të jetë në dispozicionin”.

Pas përgjigjes së Kryetarit të Gjykatës dhe obligimit ligjor prapë kemi njoftuar drejtorin e Inspeksionit të Arsimit, nga i cili kemi marrë urdhëresën për fillimin e inspektimit të lëndëve, përkatësisht të dosjeve të ndodhura në Gjykatën Themelore në Gjakovë, inspektimi i cili ka filluar më 13.05.2015. Brenda datave -4.05.2015- 13-05.2015 inspektorët e SIA në Gjakovë, janë marrë me inspektimin e Librave të amzës në Fakultetin e Edukimit – Qendra në Gjakovë (ish SHLP në Gjakovë).

Nga të dhënat e nxjerra gjatë këtij inspektimi të këtyre librave, rezulton se nga 108 rasteve (sipas Memorandumit Zyrtar me nr. Reference DHKEK/NJHKEK-RPE 238/2010, datë 16.12.2010, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë), 94 kandidat janë të evidentuar në këto libra, ndërsa 14 kandidat jo. Kandidatët e

diplomuar sipas librave amë, në SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë janë regjistruar në vitet akademike:

Në vitin akademik 1977/1978	1 kandidat
Në vitin akademik 1980/1981	1 kandidat
Në vitin akademik 1981/1982	2 kandidatë
Në vitin akademik 1983/1984	2 kandidatë
Në vitin akademik 1986/1987	1 kandidatë
Në vitin akademik 1990/1991	1 kandidatë
Në vitin akademik 1991/1992	3 kandidatë
Në vitin akademik 1992/1993	0 kandidatë
Në vitin akademik 1993/1994	6 kandidatë
Në vitin akademik 1994/1995	0 kandidatë
Në vitin akademik 1995/1996	1 kandidatë
Në vitin akademik 1996/1997	4 kandidatë
Në vitin akademik 1997/1998	7 kandidatë
Në vitin akademik 1998/1999	3 kandidatë
<u>Në vitin akademik 1999/2000</u>	<u>35 kandidatë</u>
Gjithsej.....	94 kandidatë

Kandidatët e diplomuar sipas viteve akademike:

Në vitin 1984.....	2 kandidatë
Në vitin 1994.....	1 kandidat
Në vitin 2000.....	1 kandidat
Në vitin 2001.....	3 kandidatë
Në vitin 2002.....	5 kandidatë
Në vitin 2003.....	4 kandidatë
Në vitin 2004.....	4 kandidatë
Në vitin 2005.....	23 kandidatë
Në vitin 2006.....	50 kandidatë
<u>Pa datë.....</u>	<u>1 kandidat</u>
	94 kandidatë

II. INSPEKTIMI I DOSJEVE TË KANDIDATËVE NË GJYKATËN THEMELORE NË GJAKOVË

Në Gjykatën Themelore në Gjakovë, nga inspektorët e Sektorit të Inspeksionit në Gjakovë janë inspektuar tetëdhjetë e shtatë (87) dosje të kandidatëve, të cilat po i paraqesim në vijim.

1. Bashkim Ibrahim Kilaj

INDEX Nr. 03-7561/98, Amza: 3708

Nr: 53¹

Datëlindja: 29.09.1972

Vendlindja: Lubizhdë, Malishevë

I regjistruar në SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë më 20.08.2000 (dublikatë)

Forma e studimeve: me korrespondencë

Drejtimi: Biologji-Kimi.

Data e diplomimit: 28.04.2006 me notën mesatare 6.35, nënshkruar nga dekani ,

Ka marrë certifikatë në vend të diplomës, Nr. 02-253/I, data e lëshimit, 27.05.2006

Kandidati në fjalë paraprakisht ka të kryer shkollën e mesme në SHM “Avdyl Frashëri” Malishevë, drejtimi Teknik i bujqësisë.

Në dosje ka edhe këto dokumente:

- Certifikatën e notave me nr. 358/92 dt. 28.09.2000, lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë, ku janë të evidentuara (10) provime të dhëna. Nuk ka vendim për njohje të provimeve nga Fakulteti i Edukimit .

Në indeks ka edhe këto të dhëna:

Vërtetimi i semestrave

- Semestri I dhe II viti 1998/99
- Përsëritje e semestrit të I dhe II, 1999/2000
- Përsëritje e semestrit të I dhe II, 2000/2001
- Përsëritje e semestrit të I dhe II, 2001/2002
- Semestri III, viti 2002/2003
- Semestri IV, viti 2002/2003
- Përsëritje e semestrit III dhe IV, viti 2003/2004
- Përsëritje e semestrit III dhe IV, viti 2004/2005
- Përsëritje e semestrit III dhe IV , viti 2005/2006

Në faqet 38/39 të indeksit, pa asnjë vendim janë njohur 5 provime dhe janë nënshkruar nga sekretari dhe referenti. Provimet e pranura janë në lëndët: MMP (7), Botanikë (pjesërisht) , Kimi organike (pjesërisht), Kimi inorganike (pjesërisht), Sociologji (7).

Në indeks janë të evidentuar edhe 12 provime, MMP me notë (7) dt. 21.01.2000 dhe provimi i fundit është Metodika e Biologjisë, dt. 28.04.2006 (data e diplomimit).

Në lëndën e Kimi e përgjithshme dhe inorganike nuk përputhet data e provimit. Aty kemi dy data. 07.02.2004 dhe 07.04.2004.

- Për semestrat 2004/2005/2006 ka vetëm një (1) fletëpagesë, e cila është realizuar më 13.05.2006, në vlerë 110 €, ndërsa pagesa e semestrave 2004/2005 dhe 2006 është bërë 15 ditë pas diplomimit.

¹ Nr i dosjes të ndodhur në Gjykatën Themelore të Gjakovës

Duke parë të gjitha këto, inspektori konstaton se:

- Kandidati ka indeks dublikatë, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak (para datës 20.08.2000)
- Kandidati në fjalë regjistrimin e semestrave nga viti 1998-2003, nuk e ka bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa vërtetimi i semestrave nuk përputhet me datën e regjistrimit.
- Nuk ka vendim për njohjen e provimeve të dhëna në Fakultetin e Bujqësisë
- Në fletëparaqitjen e lëndës, *Kimi e përgjithshme*, ka shkëputje datash në dhënien e provimeve.
- Pagesa e semestrave është bërë 15 ditë pas diplomimit.
- Në fletëparaqitje dhe në indeks duhet të bëhet ekzaminimi i shkrimit dhe nënshkrimeve të mësimdhënësve.

2.Faik Haxhi Mazreku, INDEKSI Nr. 03/1894/98 Nr.47²)

Datëlindja: 10.10.1961

Vendi: Guriq, Malishevë

Forma e studimeve: Me korrespondencë

Ka të kryer Gjimnazin shoqëror-gjuhësor

Në SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë ka diplomuar më 30.12.2005, Drejtimi Mësim Klasor

Në vend të diplomës ka certifikatën (Nr. 02-666/1, datë 30.12.2005)

Në dosje ka këto dokumente:Indeksin: 185/82 dosja, 06, të lëshuar nga SHLP “Bajram Curri” Gjakovës, student i rregullt.

Ka të verifikuar semestrin e I-rë viti 1982/83 dhe semestrin e dytë po ashtu 1982/83.

Ka përsëritur semestrin e parë dhe të dytë në vitin 1983/84.

Sipas këtij indeksi kandidati ka të dhëna 2 provime: Metodikën e edukatës muzikore, dt.

10.06.1983, Metodikën e edukimit figurativ, dt. 24.06.1983.

Indeksi nr:03/1894/98 dt. 15.09.2000, (dublikatë)

- Semestri I dhe II, viti 1998/99
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, 1999/2000
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, 2000/2001
- Semestri III dhe i IV, viti 2001/2002
- Përsëritje e III dhe i IV, viti 2002/2003
- Përsëritje e semestrave III dhe IV, viti 2003/2004
- Përsëritje e semestrave III dhe i IV, viti 2004/2005

Në faqen 34/35 ka dy (2) lëndë të bartura nga indeksi paraprak (185/82), në indeksin dublikatë nr: 03/1894/98 dt. 15.09.2000, provimi i parë MMP dhe VMSH me notën tetë (8), është dhënë me dt. 23.06.1983, provimi i dytë është lënda *Pedagogji me notë gjashtë (6)*. Këto nota janë të diskutueshme, sepse nuk ka dëshmi për dhënien e tyre nga indeksi paraprak dhe as ndonjë vërtetim tjetër për vlerësimin e kandidatit në mënyrë të rregullt.

Në indeks ka të evidentuara 14 provime.

Në lëndën e Matematikës, nuk korrespondon data e mbajtjes së provimit me atë të evidentimit në indeks, përkatësisht data e evidentuar në indeks me atë në fletëparaqitje. Në fletëparaqitje data është 25.12.2005, ndërsa në indeks 25.12.2006.

² Nr. i dosjes në Gjykatë

Data e fletëpagesës së semestrave 2004/2005, në vlerë prej 30 € është 09.11.2005.

Konstatimi i inspektorit:

- Notat në faqen 34/35, të bartura nga indeksi paraprak (185/82), në indeksin dublikatë nr: 03/1894/98 dt. 15.09.2000, provimi i parë *MMP dhe VMSH* me notën tetë (8), i evidentuar me dt. 23.06.1983 dhe, i dyti, *Pedagogji*, me notë gjashtë (6) dt. 23.06.1983 janë diskutabile.
- Regjistrimi i semestrave nga viti 1998-2003 nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me datën e regjistrimit.
- Nota në lëndën *Matematikë* është diskutabile, sepse në fletëparaqitje data është 25.12.2005, ndërsa në indeks është 25.12.2006.
- Në fletëparaqitje dhe në indeks duhet të bëhet ekzaminimi i shkrimit dhe nënshkrimeve të mësimitdhënësve.
- Ka indeks dublikatë edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

3. Isuf Smajl Berisha, INDEKSI Nr. 03/2019/98 Nr.49

Datëlindja: 21.11.1957

Vendi: Caravranë, Malishevë

Drejtimi – programi: Mësim Klasor

Forma e studimeve: Me korrespondencë

Shkollimi paraprak: Gjimnazin “Ramiz Sadiku” Rahovec.

Vendi i kryerjes së studimeve dhe koha e kryerjes së studimeve: SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë, më 17.07.2006, me notë mesatare 6.53

Në vend të diplomës ka certifikatë me Nr: 02/380

Date e lëshimit: 24.07.2006

Në dosje ka edhe këto dokumente:

Ekstraktin nga libri amë i të lindurve

Certifikatën e vërtetimit të semestrit IV-të në SHLP “Xhevdet Doda” Prizren (fotokopje e pavërtetuar), ku figurojnë këto të dhëna;

- Shtatë (7) provime të dhëna
- Nuk ka vendim për njohjen e provimeve nga ana e SHLP” B Curri “në Gjakovë
- Provimet nuk janë të evidentuara në indeks.

Ka indeksin nr. 03/2019/98 i lëshuar më 15.01.2005 (dublikat)

- Semestri i I-rë dhe i II-të viti 1998/99
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, 1999/2000
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, 2000/2001
- Semestri i III-të, viti 2001/2002
- Përsëritje e semestrit të III, viti 2002/2003
- Përsëritja e semestrit të IV, viti 2002/2003
- Përsëritja e semestrit të IV, viti 2003/2004
- Përsëritja e semestrit të III dhe IV, viti 2004/2005
- Përsëritja e semestri të IV, viti 2005/2006

I ka të dhëna 15 provime. Provimi i parë *MMP* është *i dhënë* më 13.02.2001, ndërsa i fundit *Metodika e gjuhës amtare* më dt. 17. 07.2006.

Ka 15 fletëparaqitje, prej tyre 2 nuk e kanë datën e mbajtjes së provimit. Shkrimi në 10 fletëparaqitje është i njëjtë.

Ka fletëpagesat e semestrave (dy copë), si; 03.04.2006 dhe 29.07.2006, pagesa e datës 29.07.2006 është bërë 12 ditë pas diplomimit (17.07.2006)

Për certifikatat, në vend të diplomës, pagesa është bërë më 09.10.2006 .

Konstatim i inspektorit:

- Regjistrimi i semestrave nga viti 1998-2005, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me datën e regjistrimit.
- Pagesa e semestrit është bërë 12 ditë pas diplomimit.
- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në 10 fletëparaqitje dhe të dëshmon fletëpagesat e regjistrimit të semestrave vit. 1998/2005.
- Ka indeks dublikat edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

4. Sahit Sejdi Morina, INDEKSI Nr. 03-8138/93 Nr.52,

Datëlindja: 15.09.1967, Vendi: Drenoc –Malishevë

Studimet i ka kryer në SHLP “B. Curri” në Gjakovë, Drejtimi Biologji-Kimi .

Në dosje ka 4 certifikata të shkollës së mesme, lëshuar nga arkivi historik i Klinës për klasën e I-rë më, nr. 64/08 dt. 09.10.2008, ku dëshmohet se me sukses e ka kryer klasën e I-rë 1982/83 në SHKM “Luigj Gurakuqi” paralelja e ndarë në Kijevë. Kl II-të nr: 65/08 dt. 09.10.2008 vitit shk. 1983/84, e ka kryer në të njëjtën shkollë . Kl III-të, nr: 66/08 viti 1984/85, Kl IV-të nr: 67/08 viti 1985/86. Ka edhe diplomë të shkollës së mesme – Kijevë.

Koha e diplomimit në SHLP në Gjakovë: 30.09.2006, me notë mesatare 6.71

Në vend të diplomës ka certifikatë (Nr: 02-100/I , dt: 21.03.2007) si dhe Diplomë, të lëshuar më 04.12.2008, nr:1115

Në dosje ka edhe:

1. Certifikatën të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë nr. 253/87 Prishtinë 19.07.2001 , ku janë të evidentuara si të dhëna 33 provime.
2. Ka vendimin për njohjen e provimeve nga Fakulteti i Bujqësisë, të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit me nr. 02-346/I, dt. 27.12.2008.

I janë njohur 2 provime për vitin e parë (I), dhe 3 provime për vitin e dytë (II) 1. MMP dhe VMSH, nota (6), Kimi e përgjithshme, nota (7) , Botanika e përgjithshme, nota (7), ndërsa për vitin e dytë i janë njohur; Sociologji, me notën (8) , MMP dhe VMSH nota (6).

Inspektori konstaton se nuk përputhet data e vendimit për njohjen e provimeve (27.12.2008) më datën e diplomimit 30.09.2006. Provimet i janë njohur dy vite pas diplomimit.

Indeksi nr. 03-8138/93, dublikatë, pa datë të lëshimit.

- Semestri i I-rë dhe i II-të është regjistruar në vitin 1993/94 (nuk ka dëshmi që në këtë kohë studenti ka qenë i regjistruar në SHLP “B. Curri” në Gjakovë).

- Përsëritje e semestrit të parë dhe të dytë 1994/95
- Përsëritje e semestrit të parë dhe të dytë 2002/2003
- Semestri i III-të dhe IV, në vitin 2003/2004
- Përsëritje semestrit III-të dhe të IV, viti 2004/2005
- Përsëritje semestrit III-të dhe të IV, viti 2005/2006

Në faqet 38/39 të indeksit janë dëshmitë për njohjen e (5) notave, sipas vendimit të dt. 27.12.2008.

Ka të dhëna 12 provime , provimi i pare është *Pedagogji* , sipas indeksit me dt. 24. 02.2002, ndërsa sipas fletëparaqitjes 29.02.2002.

Provimi i parë: Zoologjia e pakurrizorëve, dt. 22.06.2002

Provimi i dytë: Botanika e përgjithshme, dt. 24.10.2002

Provimi i tretë: Psikologji, dt .13.04.2003

Provimi i katërt: Sociologji, dt. 25. 10.2003

Provimi i pestë: Sistemi i bimëve të ulëta, dt. 21.04.2004

Provimi i gjashtë: Sistemi i bimëve të larta, dt. 18.04.2004

Provimi i shtatë: Anatomia e njeriut, dt. 19.10.2004

Provimi i tetë: Zoologjia e kurrizorëve, dt. 13.04.2005

Provimi i dymbëdhjetë: Metodika e Kimisë e dhënë me dt. 30.01.2006, ndërsa në indeks i figuron data 30.09.2006.

Konstatim i inspektorit:

- Datat e mbajtjes së provimeve prej fletëparaqitjes së pare 29.02.2002 e deri në të fundit, më 30.01.2006, është shënuar me të njëjtin laps dhe të njëjtën ngjyrë (të ekzaminohet shkrimi në fletëparaqitje).
- Të gjitha fletëpagesat janë bërë në vitin 2008, si:
 - Për indeks 50 € dt. 19.11.2008,
 - pagesa për semestër, 130 €, dt. 19.11.2008 , nuk ka pagesa të tjera.
- Pagesa e semestrit është bërë dy (2) vite pas diplomimit, (studenti ka diplomuar dt 30.09.2006 ndërsa pagesa për indeks me 19.11.2008).
- Data e vendimit për njohjen e provimeve nr. 02-346/I, dt. 27.12.2008, është lëshuar dy vite pas diplomimit.
- Provimin në lëndën, *Metodika e kimisë*, në fletëparaqitje figuron të jetë i dhënë më 30.01.2006, ndërsa në indeks i figuron data 30.09.2006
- Provimi në lëndën *Pedagogji*, në indeks i figuron e dhënë me datën 24.02.2002, ndërsa në fletëparaqitje më 29.02.2002.
- Ka indeks dublikat, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

5. Tafije Sahit Vladi

INDEKSI Nr. 767/97

Amza: 414

Nr. 48

Datëlindja: 15.08.1971, Vendi:Ferizaj

Ka studiuar në SHLP “B. Curri” Gjakovë, Dega Mësim Klasor,

Në dosje ka:

Certifikatën e lindjes.

Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë dhe 4 dëftesa.

Ka diplomuar në SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë me 30.10.2006 me notë mesatare 6.46

Ka Certifikatat në vend të diplomës 02-278/1 , mësim Klasor e rregullt, dt. 29.06.2007,
Ka indeksin nr. 03.767/97 (dublikat)

- Semestrin e I-rë dhe të II-të e ka regjistruar në vitin akademik 1999/2000
- E ka përsëritur semestrin e I dhe të II, në vitin akademik 2000/2001
- E ka regjistruar semestrin e III dhe IV, në vitin akademik 2001/2002
- E ka përsëritur semestrin III dhe IV, në vitin akademik 2002/2003
- E ka përsëritur semestrin III dhe IV, në vitin akademik 2003/2004
- E ka përsëritur semestrin III dhe IV, në vitin akademik 2004/2005
- E ka përsëritur semestrin III dhe IV, në vitin akademik 2005/2006

Ka të dhëna 15 provime, provimi i parë i dhënë 30.09.2000 nga MMP, ndërsa të fundit më 30.10.2006.

Të gjitha fletëparaqitjet janë të plotësuara me të njëjtin laps kimik dhe është i njëjti shkrim. Fletëpagesat për semestra janë realizuar në bankë me datën 09.05.2008, do të thotë 2 vite pas diplomimit

Në dosje gjendet edhe fotokopja e indeksit

Konstatim i inspektorit:

- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në fletëparaqitje.
- Pagesa në bankë për pagesën e semestrave dhe certifikatën e diplomës është bërë me datën 09.05.2008, do të thotë dy (2) vite pas diplomimit.
- Regjistrimi i semestrave nga viti 1999-2004, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi. Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me datën e regjistrimit.
- Ka indeks dublikat edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

6. ZENEL (.....) SHALA, INDEKSI Nr. 03-1925/99

Në dosje ka:

Diplomën e SH. M. "Luigj Gurakuqi", paralele Kijevë, Nr. protokolli 33/03 datë 10.06.1985, Drejtim-Pedagogji

Indeksi Nr. 03-1925/99 i lëshuar më 15.11.2000, nga SHLP "Bajram Curri" në Gjakovë, Drejtimi: Mësim Klasor,

Ka dhe dublikatin e Indeksit Nr. Dosjes K-2697 SH. L. P. "XH. Doda"-Prizren, Drejtimi mësim Klasor, data e regjistrimit 16.12.2003, data e ç' regjistruar është më 22.12.2003, Nr. 491

Në këtë Indeks Nr. Dosjes K-2697 SHLP. "Xhevdet Doda" në Prizren, janë të shënuara këto lëndë:

1. Metodika ed .politeknik	/Nota	6	(gjashtë) datë	08.06.1987
2. Metodika ed. Figurative	/Nota	6	(gjashtë) datë	18.06.1987
3. B. F. M	/Nota	6	(gjashtë) datë	21.06.1987
4. M. P. P. dhe V. M. SH.- I	/Nota	7	(shtatë) datë	30.06.1987
5. Psikologjia Pedagogjike	/Nota	6	(gjashtë) datë	16.09.1987
6. Letërsi për fëmijë	/Nota	6	(gjashtë) datë	10.10.1988

Në katër lëndë është e vendosur vetëm një notë.

Ka Certifikatën Nr. 02-483 datë 16.12.2003, të lëshuar në Prizren, në emër të Zenel.B.Shala, student i SHLP,i cili ka të vërtetuar Semestrin e I –viti i parë v.shk. 1988/1989, Dega mësim Klasor. (vërtetuar nga referenti ku konstatohet se janë të regjistruara 6 provime (përputhen me shënime).

Nuk ka vendim për njohje të provimeve.

INDEKSI Nr. 03-1925/99 i lëshuar më 15.11.2000.

Sipas indeksit Nr. 03-1925/99 i lëshuar më 15.11.2000, nga SHLP “Bajram Curri” në Gjakovë.

Janë të regjistruar semestrat:

Semestri i I 1999/200

Semestri II 2000/2001

U regjistruan:

- Semestri dimëror	(I-2)	2000-2001
- Semestri veror	(II-2)	2000-2001
- Semestri dimëror	(I-3)	2001-2002
- Semestri veror	(II-3)	2001-2002
- Semestri dimëror	(III)	2003-2004
- Semestri veror	(IV)	2003-2004

Në dosje të kandidatit gjenden 12 fletëparaqitje të nënshkuara dhe të vulosura, me nota. Ndërsa në indeks 11 nota, 6 nota nga certifikata e nxjerrë nga Prizreni.

Provimin e fundit e ka dhënë më 26.09.2004,

Në lëndën *Psikologjia Pedagogjike* – nuk përputhet data e provimit e evidentuar në fletë paraqitje me atë në indeks.

Fletëpagesa Nr. 010533, viti i studimit 2003/2004, SH. L. P.”B. Curri”, Semestri -I- me korrespondencë, 130.00 €, paguar më 29.12.2003.

Konstatim i inspektorit:

- Regjistrimi i semestrave nga viti 1999-2003, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me vitin e regjistrimit.
- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në fletëparaqitje dhe indeks.
- Shkolla e Lartë Pedagogjike “Bajram Curri” në Gjakovë, nuk ka nxjerrë vendim për njohjen e 6 provimeve nga SHLP “Xhevdet Doda” e Prizrenit.
- Indeksi nga SHLP “B. Curri në Gjakovë, me Nr.:03-1925/99, është lëshuar me 15.11.2000, ndërsa Indeksi i SHLP “Xhevdet Doda” i lëshuar në Prizren ka datën e lëshimit 13.12.2003, që do të thotë 3 vite pas regjistrimit në SHLP në Gjakovë.
- Ka indeks dublikat, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

7. Hasan M.... Hoti, Nr. INDEKSI Nr.03-1964/99

Datëlindja: 14.07.1972,

Ka të kryer SHLP- Dega, Histori-Gjeografi

Data e regjistrimi në SHLP në Gjakovë: 15.09.2000

Në dosje ka:

Dokumentacionin e shkollës së mesme;

diplomë e fituar në QMSH "17 Nëntori", Malishevë, Nr. 10, Protokoll Nr. 119, viti 1991, datë 26.08.1991 SHM, drejtimi Matematiko-Natyror.

Indeksi Nr.03-1964/99 Dosja-dublikatë, datë regjistrimi 15.09.2000, Dega, Histori-Gjeografi I ka të regjistruar Semestrin dimëror

-	Semestrin veror	(I-)	1999-2000
-	Semestrin veror	(II)	1999-2000
-	Semestrin dimëror	(I-2)	2000-2001
-	Semestrin veror	(II-2)	2001-2002
-	Semestrin dimëror	(II-3)	2001-2002
-	Semestrin veror	(I-4)	2003-2004
-	Semestrin dimëror	(II-4)	2003-2004
-	Semestrin veror	(III)	2004/2005 (pa vulë nënshkrim)
-	Semestrin dimëror	(III-2)	2005/2006
-	Semestrin veror	(III-2)	2005/2006

Lënda: Gjeografi nacionale është e plotësuar me datë 02.02.2002, e vulosur, e nënshkruar nga prof. Nesim Vala. Nota është e regjistruar në indeks me datë tjetër.

Gjithsej ka 16 fletëparaqitje të vërtetuara dhe të nënshkruara

Në indeksi ka 15 nota.

Fletëpagesat:

Dëftesë	Nr. 001160	Hasan Hoti	75.00 €	regjistrimi i semestrit 99/2000	14.04.2004
Dëftesë	Nr.001161	Hasan Hoti	25.00 €	regjistrimi i semestrit 2000/2001	14.04.2004
Dëftesë	Nr. 001161	Hasan Hoti	25.00 €	regjistrimi i semestrit 2001/2002	14.04.2004

Konstatim i inspektorit:

- Të bëhet ekzaminimi e shkrimit në fletëparaqitje, gjithashtu të verifikohet nota dhe data në fletëparaqitje në lënë Gjeografi nacionale.
- Regjistrimi i semestrave nga viti 2003-2005, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me vitin e regjistrimit.
- Nga Fakulteti i Edukimit të verifikohet notat në fletëparaqitje (16) të vërtetuara dhe nënshkruara me notat në indeks (15 nota).
- Ka indeks dublikat, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

8. Arben Musë Sahitaj,

INDEKSI Nr. 621/87, amza: 484

Nr:57

Datëlindja: 03.1959, Vendi: Ponorc, Malishevë

Studimet e kryera: SHLP-Dega mësim Klasor,

Forma e studimeve: i rregullt

Koha e diplomimit: 07.09.2006, nota mesatare 6.46, nënshkruar *për dekanin*.

Ka certifikatë në vend të diplomës, nr:02-434/I dt. 27.09.2006 dhe diploma e lëshuar më 06.08.2007, nr/821 (student i rregullt).

Indeksi nr:621/87 , dosja 34/Q , regjistruar dt. 28.08.1987/88.

E ka të vërtetuar semestrin e I-rë dhe II-të në vitin akademik 1987/88 , ka përsëritur semestrat I dhe II në v.shk.1988/89 ,

Ka regjistruar semestrin e III dhe IV v. shk. 004/2005 ,

E ka përsëritur semestrin e III dhe IV v. shk. 2005/2006.

Ka të dhëna këto provime:

1. MMP dhe VMSH, me notën (6) dt. 20.06.1988
2. Bazat e psikologjisë, me notën (6) dt. 17.10.2004
3. Letërsi për fëmijë, me notën (6) dt. 26.10.2004
4. Matematikë, me notën (6)dt. 23.06.2005
5. Gjuhe e sotme Shqipe, me notën (6)dt. 10.06.2005
6. Metodikë e matematikës, me notën (7)dt. 13.09.2005
7. Metodika e edukatës muzikore (6) në indeks:dt. 11.04.2005, ndërsa në fletëparaqitje dt. 11.09.2005 (të verifikohet nga eksperti)
8. Metodika e DNSH me notën (6)dt. 28.04.2005
9. Psikologji pedagogjike me notën (7)dt. 03.09.2005
10. Sociologji, me notën (7)dt. 12.04.2006
11. Metodika e artit figurativ, me notën(7)dt. 27.06.2005
12. Metodika e edukatës fizike, me notën(8)dt. 29.06.2006
13. Didaktika me notën (6)dt. 07.09.2006

Dokumentacioni tjetër:

1. Diplomën Nr:3/137 viti 1982, QAMO “Luigj Gurakuqi”, paralelja e ndarë Kijevë, me certifikatat e vitit të I, II, III, IV.
2. Pyetësorin që dëshmon se kandidati i plotëson kushtet për SHLP
3. Procesverbalin e provimit pranues
4. Certifikatën e gjendjes shëndetësore
5. Certifikatën e lindjes
6. Lutje (kërkesë) për regjistrimin e vitit të I, dt. 29.06.1987
7. Lutje dhe fletëparaqitje me pagesa për regjistrimin e semestrit të (1²) dt. 06.01.1989
8. Lutje dhe fletën semestrare për vërtetimin e semestrit të II- të dt. 10.06.1988
9. Lutje dhe fletëparaqitje për regjistrimin e semestrit veror dt: 15.01.1988
10. Fletëpagesa (3) të vitit 1987
11. Fletëpagesa dt. 18.07.2006, pagesa 110 €, viti i studimeve 2005/2006 pagese e provimeve datë:30.08.2006, viti i studimeve 2005/2006.
Për certifikatë të notave dhe 09.10.2006 , 10 € për diploma.

Konstatim i inspektorit:

- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në fletëparaqitje dhe indeks.
- Në lëndën, Metodika e edukatës muzikore e ka notën (6) në indeks, dt. 11.04.2005, ndërsa në fletëparaqitje dt. 11.09.2005 (të verifikohet nga eksperti validiteti i provimit- Fakulteti i Edukimit)

9. Hamide/ Muharrem/Kryeziu – Shijaku

INDEKSI 03-7714/91

Nr: 56

E lindur dt:01.06.1972 në Mleqan, Malishevë

Ka diplomuar me dt: 30.11.2005 në Drejtimin: Biologji – Kimi,

Në vend të diplomës ka certifikatë,e nënshkruar, për Dekanin, H. Hasimja

Indeksi: Nr: 03-7714/91, Dublikat, regjistruar me dt:15.09.2000

-Semestri I dhe II Viti 1991/ 1992

-Përsëritur I dhe II viti 1992/ 1993

-Përsëritur III dhe IV viti 1998/ 1999

-Përsëritur III dhe IV viti 2000/ 2001

-Përsëritur III dhe IV viti 2001/2002

- Përsëritur III dhe IV viti 2002/2003
- Përsëritur III dhe IV viti 2003/2004
- Përsëritur III dhe IV viti 2004/2005
- Përsëritur III dhe IV viti 2005/2006

Në faqet 38/39 të Indeksit janë të pranuar (8) provime sipas certifikatës së notave, lëshuar nga SHLP “Bajram Burri” në Gjakovë, Nr: 02-7714/91 nënshkruar nga sekretari Nijazi Xharavina. Data e nënshkrimit: 15.02.2002. Dokumenti është fotokopje.

Provimet e pranuar:

Viti i I

1. MPP dhe VMSH (6) gjashtë
2. Pedagogji (6) gjashtë
3. Psikologji (6) gjashtë
4. Botanika e përgjithshme (6) gjashtë
5. Kimi e përgjithshme (6) gjashtë
6. Zoologji e pakurriorëve (6) gjashtë

Viti i II

7. Sociologji (6) gjashtë
8. Anatomia e njeriut (6) gjashtë

Fletëparaqitjet

1. Sistematika e bimëve të ulëta (6) dt: 21.04.2004
2. Zoologjia e kurriorëve (6) dt: 29.09.2004
3. Sistematika e bimëve të larta (6) dt: 17.06.2004
4. Kimia Organike (6) dt:23.06.2005
5. Metodika e Biologjisë (7) dt: 28.09.2005
6. Metodika e kimisë (7) dt: 30.11.2005

Në dosje ka edhe:

Certifikatën e lindjes, dhe dy pagesa të bëra me datë: 10.02.2006. Vlera 30 € për pagesën e semestrave 2004/2005 dhe pagesën e semestrit 2005/2006 është 60 €. Data e bërjes së pagesës është 10.02.2006.

Konstatimi i inspektorit:

- **Të ekzaminohen të gjitha nënshkrimet e profesorëve dhe shkrimi në fletëparaqitje dhe në indeks.**
- **Pagesa e semestrave për vitin akademik 2004/2005 është bërë më datën 10.02.2006, ndërsa kandidatja ka diplomuar me 30.11.2005 (pagesa është bërë 2 muaj pas diplomimit).**
- **Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me vitin e regjistrimit.**
- **Regjistrimi i semestrave nga viti 1998-2003, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.**
- **Ka indeks dublikat, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.**

10. Isuf/ Hamdi/ Kastrati
INDEKSI Nr: 03-350/96
Nr:55

I lindur 01.03.1967 në Turjakë, Malishevë

Ka të kryer SHLP-Dega: Biologji – Kimi,

Ka diplomuar me dt: 14.12.2006, me notë mesatare: 6.42, nënshkruar në vend të dekanit.

Në vend të diplomës ka certifikatë, Nr: 02-671/ I dt: 22.12.2006.

Paraprakisht ka të kryer QAMO, "Gani Qafdarbasha" në Prizren, dega e Makinerisë, Diploma Nr: 985/1986, ka dhe katër (4) dëftesa.

Ka certifikatën e lindjes, atë të notave, të lëshuar nga Fakulteti i Bujqësisë Nr: 53/87 dt: 05.07.2006

Indeksi: Nr: 03-350/96, Dublikat, forma e kryerjes së studimeve me korrespondencë, i regjistruar dt: 15.09.2005

- Semestri i I dhe II-të viti 1996/97
- Përsëritje e semestrit të I dhe II, viti 1998/99
- Regjistrimi semestrit të III dhe IV, viti 1999/2000
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2000/2001
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2001/2002
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2002/2003
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2003/2004
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2004/2005.
- Përsëritje -//-/--/--/--/- viti 2005/2006

Notat

Pa asnjë vendim, në faqet 38/39 të indeksit, por vetëm sipas certifikatës së notave Nr: 53/87 dt: 05.07.2006, janë pranuar notat:

1. MPP tetë (8)
2. Psikologji gjashtë (6)
3. Botanikë e përgjithshme (6), lëndë e cila nuk figuron fare në certifikatën e lartcekur.
4. Zoologji e pakurrizoreve (6)
5. Anatomia e njeriut (6). Kjo lëndë nuk ekziston në certifikatën e notave, ndërsa në certifikatë është evidentuar lënda *Anatomia e kafshëve shtëpiake*.

Provimet e dhëna :

1. Zoologjia e kurrizorëve, me notë (7) dt: 11.04.2006
2. Sistematika e bimëve të ulëta, me notë (6) dt: 20.04.2006
3. Sistematika e bimëve të larta, me notë (6) dt: 21.06.2006
4. Sociologji, me notë(6) dt: 02.07.2006
5. Kimia Organike, me notë(6) dt: 20.09.2006
6. Kimia e përgjithshme dhe inorganike (6) dt: 15.09.2006
7. Metodika e biologjisë, (6) dt: 27.09.2006
8. Metodika e Kimisë, (6) dt: 27.09.2006
9. Pedagogji, (6) dt: 14.12.2006

Në dosje janë edhe fletëparaqitjet e lëndëve, por shkrimi dhe nënshkrimet janë të dyshimta. Janë edhe pesë (5) fletëparaqitje, të cilat janë plotësuar por notat nuk janë evidentuar në INDEX. Këto fletëparaqitje janë dublifikim i provime të njohura nga Fakultetin e Bujqësisë.

Fletëpagesat: Fletëpagesa e datës 31.10.2006, pagesa për semestër në vlerë 110 €. Kjo pagese është e dyshimtë, sepse pala e ka bërë pagesën e semestrit katërmëdhjetë (14) ditë para se të diplomojë

Konstatim i inspektorit:

- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në indeks dhe fletëparaqitje.

- Fletëpagesa e semestrit është bërë katërmbëdhjetë (14) ditë para diplomimit.
- Njohja e provimeve është bërë pa vendim dhe janë njohur provimet në lëndët të cilave studentit fare nuk iu ka nënshtruar në Fakultetin e Bujqësisë.
- Pesë (5) fletëparaqitje të cilat janë plotësuar, por notat nuk janë evidentuar në INDEX dhe të cilat janë dublikim i notave të pranuar nga Fakultetin e Bujqësisë, janë të dyshimta.
- Ka indeks dublikatë, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

11. Rexhep/ Zejnullah/ Kryeziu
INDEKSI Nr: 494/83 dosja: 39/01
Nr: 46,

I lindur me dt: 28.09.1955 në Pagarushë, Malishevë.

Ka të kryer SHLP-Dega: Mësim Klasor.

Ka diplomuar me dt:17.07.2006, nota mesatare 6.27

Certifikata në vend të diplomës, Nr: 02-395/ I, dt: 04.08.2006, e nënshkruar në vend të Dekanit.

Indeksi: Nr: 494/83 dosja: 39/01, regjistruar me dt: 01.11.1983, si student me korrespondencë.

- Viti i I – rë 1983/1984
- Viti i II – të 1984/1985
- Viti i II (Përsëritje)
- 1985/1986
- Viti i II (Përsëritje) 1986/1987
- Viti i II (Përsëritje)1987/1988
- Semestri i III dhe IV 2004/2005
- Përsëritje semestri i III dhe IV, 2004/2005
- Përsëritje semestri i III dhe IV, 2005/2006

Në fletën 28/29 të INDEX- it, sipas vendimit Nr: 03-32/1 datë: 18.10.1983 i janë njohur shtatë (7) provime (njohja është në rregull).

Me datë: 22.06.1985 e ka dhënë provimin me shkrim-kollokviumin në lëndën e Matematikës.

Provimet tjera:

1. Pedagogji nota (6) datë: 17.06.2000
2. Sociologji notë (7) datë: 21.04.2002
3. Bazat e Psikologjisë gjenetike notë (6) datë: 29.09.2002
4. Metodika e DNSH notë (7) datë: 16.10.2005
5. Didaktika nota (6) datë: dt:23.06.2005.
Në kë lëndë, në fletëparaqitje data e dhënies së provimit është 25.06.2005 ndërsa në INDEKS është dt:23.06.2005
6. Metodika e Muzikës nota (7) datë: 13.09.2005
7. Metodika e Edukatës Fizike nota (8) datë: 14.11.2005
8. Pedagogjia e Përgjithshme nota (6) datë: 03.06.2006
9. Metodika e Matematikës nota (7) datë: 30.06.2006
10. Metodika e Gjuhës Amtare nota (6) datë: 17.06.2006

Fletëpagesat:

Ka dy (2) fletëpagesa. Më 03.07.2006 pagesa për semestrit 2005/2006, 110 € (pagesa e semestrit është bërë 14 ditë para se sa të diplomojë) , dhe pagesa për Certifikatën e Diplomës, më 09.09.2006 , në vlerë 10 €.

Konstatimi i inspektorit:

- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në fletëparaqitje dhe i nënshkrimit të mësimdhënësve.
- Fletëpagesa e datës 03.07.2006 për pagesën e semestrit 2005/2006, 110 € është diskutabile (pagesa e semestrit është bërë 14 ditë para se sa të diplomoj).
- Regjistrimi i semestrave për vitin 2004/2005, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me vitin e regjistrimit
- Vlerësimi me notë në lëndët: Pedagogji, Sociologji dhe Bazat e Psikologjisë gjenetike është diskutabil, sepse semestrat e viteve në kohën kur janë evidentuar si të dhëna këto provime nuk figurojnë të regjistruar.

12.

Fazli/ Shaban / Krasniqi
INDEKSI Nr: 03- 2025/98
Nr: 32

I lindur më 18.11.1961 në Pagarushë, Malishevë
Është regjistruar në SHLP-Dega: Mësim klasor,
Ka diplomuar me datë:03.06.2006 , nota mesatare 6.26 ,
E ka diplomën Nr: 766 datë 14.04.2007.

Shkollimin e mesëm e ka të kryer në shkollën e Mesme Ekonomike “Gani Qafdarbasha” në Prizren,-drejtimi teknik i Makinerisë, Nr i Protokollit; 507/a

E ka Diplomën- fotokopje të Shkollës së Lartë Teknike në Mitrovice, Nr: 2548 datë: 25.12.1987.

E ka vërtetimin “Uverenje Opollozhenim Ispitima”- Certifikatë për provime Nr: 2155 datë: 05.05.2006 lëshuar nga “Visha Tëhnicko Shkolla në Zveçan” dhe e ka vendimin për njohjen e provimeve Nr: 02-370/I datë 27.12.2008, lëshuar nga Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, ku janë njohur dy (2) provime. Ky vendim është nxjerrur dy vite pas diplomimit të kandidatit

Provimet janë:

Për vitin e pare (I)

1. MPP dhe VMSH me notë (6)
Për vitin e dytë (II)
1. Sociologji me notë (6)

Në dosje ka edhe:

Indeksi: Nr: 2155 Dosja: 2155, Universiteti i Prishtinës- Shkolla e Lartë Teknike, dega e Makinerisë

Indeksi: Nr: 03- 2025/98, Dosja: KO/ Dublikatë, Regjistruar datë: 15.02.2005

- Semestri I dhe II në vitin 1998/1999
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, viti 1999/2000
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, viti 2000/2001
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, viti 2001/2002
- Përsëritje e semestrit të I-rë dhe II-të, viti 2002/2003
- Semestri i III-të dhe IV, viti 2003/2004
- Përsëritje e semestrit të III-të dhe IV, viti 2005/2006

Në faqen 38/39 të INDEXIT, janë dy provime të pranuar sipas vendimit.

Fletëparaqitjet:

1. Letërsi për fëmijë me notë (6) datë: 05.04.2002
2. Pedagogji me notë (6) datë: 25.06.2002
3. Gjuhë e sotme shqipe me notë (6) datë: 21.01.2003
4. Bazat e psikologjisë me psikologji gjenetike, me notë(6) datë: 08.02.2003
5. Metodika e Edukatës figurative me notë (8) datë:27.06.2003
6. Metodika NDSH me notë (6) datë: 10.02.2004
7. Metodika e Edukatës fizike me notë (7) datë:27.04.2004
8. Metodika e Gjuhës Amtare me notë (6) datë: 20.09.2004
9. Metodika e Edukatës Muzikore me notë (6) datë: 07.02.2005
10. Matematika me notë (6) datë: 25.12.2005
11. Metodika e Matematikës me notë (6) datë: 30.12.2005
12. Didaktika me notë (6) datë: 11.01.2006
13. Psikologjia Pedagogjike me notë (6) datë:03.06.2006

Ka trembëdhjetë (13) fletëparaqitje, ku dyshohet se shkrimi në to është bërë nga e njëjta dorë.

Ka gjithsej pesëmbëdhjetë (15) provime

Ka edhe certifikatën e lindjes

Konstatim i Inspektorit:

- Shkrimi në fletëparaqitje dyshohet të jetë bërë nga e njëjta dorë, pra nga i njëjti person.
- Nuk ka dëshmi të pagesave për semestrat nga viti 1998/99 deri në vitin 2005/2006.
- Vërtetimi i semestrave nuk përputhet me vitin e regjistrimit.
- Nuk ka semestër të regjistruar për vitin 2004/2005.
- Vendimi për njohje të provimeve është nxjerrë një vit pas diplomimit të kandidatit.
- Ka indeks dublikate, dhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

13. Sadete / Hasan/ Berisha INDEKSI NR: 03-2060/98 Nr: 42,

E lindur me dt: 28.03.1962 në Volljakë Klinë.

Është regjistruar në SHLP- Dega: Mësim Klasor me datë 15..... 2005 (me korrespondencë)

Ka diplomuar me dt: 30.09.2006, nota mesatare 6.35,

E ka certifikatën në vend të diplomës (Nr: 02-556/ I datë 10.11.2006) e nënshkruar nga person tjetër me *në vend të Dekanit*.

Ka kryer shkollën e mesme “Luigj Gurakuqi” Klinë-Teknik i kontabilitetit. Numri rendor i regjistrimit, Nr:27

Ka certifikatë të lindjes,

Dëshmitë mbi kryerjen e kl. I, II, III, IV të shkollës së mesme.

E ka indeksin: NR: 03-2060/98, Dublikat, data e regjistrimit dt: 15..... 2005

(Korrespondence)

- Semestri i I-rë dhe i II-të, viti 1998/1999
- Përsëritja e semestrit të I-rë dhe i II-të, viti 2000/2001
- Përsëritja e semestrit të I-rë dhe i II-të, viti 2001/2002
- Semestri i III-të dhe IV, viti 2002/2003
- Përsëritja e semestrit të III-të dhe IV, viti 2003/2004
- Përsëritja e semestrit të III-të dhe IV, viti 2004/2005

- Përsëritja e semestrit të III-të dhe IV, viti 2005/2006

Fletëparaqitjet:

1. Pedagogji me notë (6) datë: 31.01.2002
2. Letërsi për fëmij me notë (7) datë: 05.04.2002
3. Gjuha e sotme Shqipe me notë (6) datë: 20.09.2002
4. Bazat e Psikologjisë me psikologji gjenetike me notë (6) datë: 20.04.2003
5. Sociologji me notë (7) datë: 28.06.2003
6. Metodika e DNSH me notë (6) datë: 26.09.2003
7. Metodika e Artit figurativ me notë (8) datë: 23.04.2004
8. Metodika e Edukatës fizike me notë (7) datë: 29.06.2004
9. Metodika e Gjuhës Amtare me notë (6) datë: 20.09.2004
10. Didaktika me notë (6) datë: 21.10.2004
11. Metodika e Eduk. Muzikore me notë (6) datë: 23.06.2005
12. Matematika me notë (6) at: 25.12.2005
13. Metodika e Matematikës me notë (6) datë: 30.09.2006
14. Psikologjia pedagogjike me notë (6), data e provimit në INDEX është 09.09.2006, ndërsa në fletëparaqitje është dt. 26.09.2005, çka do të thotë një vit ndryshim.

Fletëpagesat:

Është vetëm një (1) fletëpagesë si dëshmi për pagesën e semestrave III dhe IV të viteve 2004/2005 dhe 2005/2006, datë: 18.10.2006 në vlerë 110 €. Fletëpagesa është bërë pas datës së diplomimit.

Konstatim i inspektorit:

- Kandidati i ka të dhëna vetëm (14) provime, nuk dihet se sa lëndë ka pasur drejtimi i Mësimit klasor në vitet akademike kur ka studiuar kandidati.
- Fletëpagesa e semestrave të III dhe IV datë 2004/2005, 2005/2006 është bërë (18) ditë pas diplomimit.
- Dymbëdhjetë (12) fletëparaqitje janë të shënuara me të njëjtin laps dhe ngjyrë, gjë që kërkon ekzaminim.
- Ka indeks dublikat, edhe pse nuk ka dëshmi për regjistrim paraprak.

14. Bilall /Sylë/ Rudi

INDEKSI Nr. 03-1452/99, Nr: 45,

I i lindur me dt: 01.04.1957 në Ponorc, Malishevë.

I ka kryer studimet në SHLP, mësim Klasor. Data e regjistrimit: 15.03.2005

Ka diplomuar me dt: 25.12.2005, Mësim klasor,

Ka Certifikatë në vend të diplomës Nr:02 – 71/ I datë: 16.01.2006, nënshkruar nga Dekani.

E ka kryer shkollën e mesme në Rahovec, Drejtimi: Gjinnaz, gjuhësor- shoqëror, numri i protokollit Nr: 1370, ka edhe dëftesat e vitit të III dhe IV të shkollës së mesme.

Indeksi: NR: 03-1452/99, Dublikat. Data e regjistrimit: 15.03.2005

- Semestri i I dhe II, viti 1999/2000
- Përsëritje e semestrit I dhe II, viti 2000/2001
- Përsëritje e semestrit. I dhe II, viti 2001/2002
- Semestri i III dhe IV, viti 2002/2003
- Përsëritje e semestrit III dhe IV, viti 2003/2004
- Përsëritje e semestrit III dhe IV, viti 2004/2005
- Përsëritje e semestrit III dhe IV, viti 2005/2006

I ka të dhëna katërmbëdhjetë (14) provime

1. MPP (Mbrojtja e përgjithshme popullore) notë (7) datë: 31.01.2001
2. Letërsia për fëmijë, me notë (6) datë: 08.04.2003
3. Gjuha e sotme shqipe, me notë (6) datë: 24.06.2003
4. Bazat e Psikologjisë me Psikologji Zhvillimore, notë (6) në fletëparaqitje është dt: 14.09.2003, ndërsa në INDEX 13.09.2003
5. Matematikë, me notë (6) në fletëparaqitje data është 19.09.2005 e shënuar nga profesori, dhe 12.09.2005 e shënuar nga studenti, ndërsa në INDEKS data është 19.09.2005
6. Pedagogji, me notë (6) datë: 08.04.2004
7. Metodika e DNSH, me notë (6) datë: 22.06.2004
8. Metodika e Edukatë fizike, me notë (8) datë: 28.09.2004
9. Metodikë e Artit figurativ, me notë (8) datë: 15.10.2004
10. Didaktikë, me notë (6) datë: 22.10.2004
11. Sociologji, me notë (7) datë: 26.10.2004
12. Metodika e Edukatës Muzikore, me notë (6) datë: 26.09.2005
13. Metodika e Gjuhës Amtare, me notë (6) datë: 30.09.2005
14. Metodika e Matematikës, me notë (6) datë: 25.12.2005

Në INDEX, mungon nota e lëndë Psikologjia Pedagogjike.

Ka fletëparaqitje për këtë lëndë (dt: 03.09.2005) e vlerësuar me notën (6)
Ka dy (2) fletëpagesa për regjistrim të semestrave III dhe IV datë: 19.12.2000

Konstatim i Inspektorit

- Të bëhet ekzaminimi i shkrimit në fletëparaqitje dhe në indeks
- Ka diplomuar pa evidentimin e notës në INDEX në lëndën Psikologji Pedagogjike.
- Në Lëndën Bazat e Psikologjisë me Psikologji zhvillimore nuk përputhen datat. Në fletëparaqitje është dt: 14.09.2003, ndërsa në INDEX 13.09.2003.
- Regjistrimi i semestrave nga viti 2002-2006, nuk është bërë me pagesa të semestrave e as me ndonjë dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
